



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT LEZHË

V E N D I M
Nr.49, datë 16.10.2015

“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SE ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TE
KESHILLIT TE QARKUT”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshur, Këshilli i Qarkut Lezhë

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores rregullorese se organizimit dhe funksionimit te keshillit te qarkut, bashkengjitur ketij vendimi.
2. Shfuqizimin e Vendimit Nr.9 datë 20.04.2001. “Per miratimin e rregullores se Keshillit te Qarkut Lezhe”.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Esmeralda NDOKA

KRYETARI

Gjok Ndoka



RREGULLORJA

E

KESHILLIT

TE

QARKUT LEZHE

Tetor 2015



PJESA E PARE

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KESHILLIT

KREU I DISPOZITA PARAPRAKE

Neni 1 Objekti rregullores

1. Kjo rregullore ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Lezhe në bazë të Kushtetutës, ligjeve, akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Kompetencat e Keshillit te Qarkut

1. Këshilli Qarkut është person juridik, Ai është organ përfaqësues i qarkut dhe përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të Bashkive që bëjnë pjesë në Qark të cilët janë kurdoherë anëtarë të Këshillit të Qarkut së bashku me kryetarët e bashkive përkatëse. Këshilli Qarkut vepron në bazë të parimit të autonomisë vendore.
2. Këshilli i Qarkut miraton rregulloren e tij të brëndshme të funksionimit.
3. Vendos për nivelin e ndihmesave financiare të detyrueshme të çdo bashkie përbërëse në buxhetin e qarkut.
4. Zgjedh dhe shkarkon nga anëtarët e Këshillit të Qarkut Kryetarin, Zevendes kryetarin dhe anëtarët e kryesisë.
5. Emëron dhe shkarkon sekretarin e Këshillit të Qarkut.
6. Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, numrin e personelit, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregëtare, personave të tjerë juridik që krijon vetë ose është bashkëthemelues.
8. Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
9. Miraton tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të të tretëve.
10. Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brëndshëm.
11. Vendos për taksat dhe tarifatat në kompetencë të qarkut si dhe për nivelin e tyre .
12. Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
13. Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore.
14. Emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë së tij.
15. Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.



- Vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut.
16. Miraton norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve të deleguara në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark.
 17. Vendos për simbolet e qarkut.
 18. Jep tituj nderi e stimuj. Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark.
 19. Miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së qarkut.

Neni 3

Mbledhja e parë konsituimit të keshillit

1. Mbledhja e parë e Keshillit të Qarkut, thirret brenda 50 diteve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve dhe në përputhje me ligjin Nr 8652 date 31.07.2000, i ndryshuar
2. Mbledhja e parë e Keshillit të Qarkut, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Keshillit, hapet dhe drejtohet nga Kryetari Bashkise qender Qarku. Në rast mospranimi ose mungese, mbledhja drejtohet nga këshilltari që është pas tij më i vjetër nga radhet e këshilltareve.
3. Në mbledhjen e tij të parë Këshilli Qarkut zgjedh komisionin e mandateve i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit, zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e Këshillit të Qarkut.
4. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Keshillit nuk zhvillohet asnjë debat.

Neni 4

Verifikimi i mandateve

1. Me hapjen e mbledhjes së parë të keshillit, drejtuesi i seancës i njofton Keshillit emrat e personave të zgjedhur dhe kërkon verifikimin e mandateve të tyre.

Neni 5

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve

1. Keshilli, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh një Komision të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve të anëtarëve të Keshillit. Komisioni përbëhet nga 3 këshilltare dhe pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Keshillit siç del nga rezultati i zgjedhjeve.
2. Propozimet për përbërjen dhe Kryesinë e Komisionit bëhen nga përfaqësuesit e grupimeve politike dhe miratohen nga Keshilli me votim të hapur, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.
3. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të antareve të Keshillit të Qarkut dhe i paraqet Keshillit në mbledhje raportin për vlefshmërinë e mandateve të Keshillit.



Neni 6 Betimi i keshilltareve

1. Menjëherë pas verifikimit të mandateve keshilltaret ftohen të bëjnë betimin.
2. Teksti i betimit është: "Betohe me ne emer te zgjedhesve qe perfaqesoj, te mbroj Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e saj. Betohe me se ne te gjithë veprimtarine time do te udhehiqem nga interesat e shtetasve te Bashkise Lezhe, dhe do te punoj me ndersheri e perkushtim per zhvillimin dhe rritjen e mireqenjes se tyre."
3. Teksti i betimit lexohet nga drejtuesi i mbledhjes dhe keshilltaret ftohen, një e nga një, të ngrihen në këmbë dhe të deklarojnë "Betohe me".
4. Keshilltaret që mungojnë në seancën kur kryhet betimi, betohen në seancën më të parë në të cilën marrin pjesë.
5. Drejtuesi i mbledhjes, në këshillim me Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve, deklaron mbarimin e mandatit të Keshilltarit kur ai nuk pranon të betohet ose i shmanget betimit

KREU II

KRYETARI I KESHILLIT, ZEVENDESKRYETARI KESHILLIT, KRYESIA E KESHILLIT

Neni 7 Organet drejtuese

1. Menjëherë pas kryerjes së betimit nga keshilltaret, procedohet me zgjedhjen e Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe të tre antarëve tjerë të Kryesisë së Keshillit të Qarkut.

Neni 8 Zgjedhja e Kryetarit të Keshillit

1. Kandidati për Kryetar të Keshillit propozohet si rregull nga grupe politike keshilltaresh, por asnjë keshilltare nuk përjashtohet nga e drejta propozimit.
2. Kryetari i Keshillit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave të keshillit, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Keshillit. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet me një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.
3. Votimi organizohet publikisht dhe drejtohet nga një komision votimi, i përbërë prej 3 keshilltaresh, që pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Keshillit.
4. Drejtuesi i mbledhjes fton menjëherë Kryetarin e Keshillit të zërë vendin e tij.



Neni 9 Kryetari i Keshillit Qarkut

1. Kryetari i Këshillit përfaqëson Këshillin e Qarkut në marrëdhënie me organet shtetërore, me organet e njësisive të qeverisjes vendore, me persona juridik ose fizik vendas ose të huaj.
2. Kryeson mbledhjet e Këshillit të Qarkut dhe ato të kryesisë së tij.
3. Nënshkruan të gjitha aktet e këshillit, kryesisë së këshillit dhe procesverbalet e këtyre mbledhjeve.
4. Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Qarkut dhe të kryesisë së tij.
5. Në përputhje me tematikën e mbledhjeve të kryesisë e të këshillit, miraton raportet, projekt-vendimet e materialet e tjera të nevojshme të ardhura nga departamentet e këshillit dhe institucionet përkatëse.
6. Drejton administratën e Këshillit të Qarkut dhe përgjigjet për funksionimin e saj.
7. Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së Këshillit të Qarkut përveç rasteve të parashikuara ndryshe nga ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.
8. Garanton kryerjen e funksioneve të Këshillit të Qarkut, funksionimin normal të strukturave të tij.
9. Ushtron kompetenca të tjera që i ngarkohen me ligj.
10. Kryen cdo detyre tjetër të autorizuar nga Keshilli Qarkut

Neni 10 Zëvendëskryetari Keshillit Qarkut

1. Zëvendëskryetari zgjidhet me të njëjten procedurë që zgjidhet kryetari i keshillit Qarkut.
2. Zv/Kryetari i Keshillit bashkëpunon me Kryetarin e Keshillit për realizimin e detyrave të Kryetarit.
3. Në rast se Kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon zëvendëskryetarin për kryerjen e detyres.

Neni 11 Kryesia e Keshillit Qarku

1. Kryesia përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 3 anëtarë të tjerë. Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.
2. Miraton projekt aktet dhe materialet e tjera që kërkon ajo vetë apo këshilli në përputhje me rendin e ditës e tematikën e mbledhjeve të këshillit.
3. Raporton në këshill për gjëndjen ekonomiko-financiare. Raporton në këshill për probleme që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut dhe ushtron të drejtat që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.
4. Nxjerr vendime që marrin fuqi detyruese për tu zbatuar nga organet, personat dhe subjektet e interesuara.



5. Vendimet e kryesisë duhet të raportohen e të miratohen në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Qarkut në rast të kundërt e humbasin fuqinë e tyre.

Neni 12

Sekretari Keshillit te Qarkut

1. Sekretari i Këshillit të Qarkut emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Qarkut.
2. Sekretari i Këshillit të Qarkut është përgjegjës për:
 - ▲ Mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit.
 - ▲ Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës.
 - ▲ Njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit.
 - ▲ Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga Këshilli i Qarkut.
 - ▲ Mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
 - ▲ Organizon numërimin e votave të votimit të hapur dhe njofton për rezultatin.
 - ▲ Ndjek zbatimin e vendimeve te Keshillit
 - ▲ Sekretari i Këshillit të Qarkut kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga këshilli.

Neni 13

Komisionet e Këshillit Qarkut

1. Komisionet e Këshillit janë organe të Këshillit Qarkut që kryejnë funksione për njohjen dhe realizimin e iniciativës dhe të kontrollit në kuadrin e detyrave dhe kompetencave ligjore të Këshillit.
2. Komisionet e këshillit janë të përhershëm e të përkohshëm.
3. Numri Komisioneve si dhe numri dhe anëtarët për çdo komision zgjidhen me votim të hapur me propozim të Kryetarit të Këshillit pas konsultimit me kryetarët e grupeve.
4. Në komisionet e përhershme marrin pjesë të gjithë këshilltarët dhe përbërja e tyre, për aq sa është e mundur, pasqyron grupet politike, sipas përpjesëtimit që zënë në Keshill.
5. Kryetari i Keshillit dhe Zv/Kryetari nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të përhershme.
6. Keshilltari mund të jetë anëtar deri në 3 (tre) komisione të përhershëm te keshillit
7. Kryetarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e tyre.
8. Komisionet e përhershme në bashkëpunim me kryetarin dhe administratën e Këshillit të Qarkut përgatisin projekt-vendimet, projekt-rregulloret, projekt-urdhëresat dhe ia paraqesin për miratim Këshillit.
9. Komisionet diskutojnë projektet e përgatitura nga Kryetari dhe administrata e tij dhe i propozojnë Këshillit pranimin ose jo të tyre, ndryshimin dhe plotësimin e tyre.
10. Këshilli mund të bëjë ndryshime në llojin, numrin dhe përbërjen e komisioneve të këshillit.



11. Në komisione mund të ftohen për konsultime , pa të drejtë vote, edhe persona të jashtëm apo ekspertë për çështje të ndryshme.
12. Komisioni i ligjeve shqyrton projekt-vendimet apo projekt-aktet e tjera që do t'i paraqiten mbledhjes së këshillit dhe jep relacion me shkrim për pajtueshmërinë e tyre me dispozitat ligjore në fuqi.
13. Mbledhjet e komisionit janë gjithmonë të hapura, përveç rasteve që parashikon ndryshe në ligj.
14. Nënpunësit e administratës së këshillit, ndërmarrjeve të varësisë dhe instancioneve të tjera shtetërore janë të detyruar t'u japin të dhënat që kërkohen nga komisionet e Këshillit. Komisioni mblidhet me thirrjen e Kryetarit, të zëvendëskryetarit, apo 1/3 e anëtarëve.
15. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë më tepër se gjysma e këshilltarëve.

Neni 14

Komisionet e përhershme të Këshillit

1. Prane këshillit të Qarkut Lezhe të ngrihen 6 (gjashtë) komisione të përhershme me emetime si më poshtë:
 - ▲ Komisioni mandateve dhe rregullores
 - ▲ Komisioni i ekonomisë, auditit dhe çështjeve ligjore
 - ▲ Komisioni i arsimit, shëndetësisë, problemeve sociale & emergjencave
 - ▲ Komisioni i administrimit dhe mbrojtjes së territorit
 - ▲ Komisioni i marrëdhënjëve me jashtë
 - ▲ Komisioni i politikave të zhvillimit

Neni 15

Komisionet e posaçme

1. Këshilli mund të vendosë krijimin e një komisioni të posaçëm për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave vendimarrëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë.
2. Propozimi për krijimin e komisionit të posaçëm mund të bëhet nga Kryetari i Këshillit, nga një komision i përhershëm, nga një grup politik ose nga të paktën 3 (tre) këshilltarë.
3. Këshilli, brenda muajit përcakton me vendim të vecantë detyrat, numrin, përbërjen dhe afatin kohor të veprimtarisë së komisionit të posaçëm.
4. Rregullat procedurale, të përcaktuara në nenet e kësaj Rregulloreje për komisionet e zakonshme, zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet ndryshe.



KREU III GRUPET POLITIKE

Neni 16 Formimi i grupeve politike

1. Keshilltaret mund të formojnë grupe sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik.
2. Për krijimin e një grupi kërkohet një minimum prej 3 (tre) keshilltaresh. Çdo Keshilltare mund të jetë anëtar vetëm i një grupi politik. Një keshilltare që largohet nga grupi , mund t'i bashkohet një grupi tjetër vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit.
3. Kur numri i keshilltareve të një grupi politik bie nën numrin e parashikuar nga pika 2 e këtij neni, grupi pushon së ekzistuari.
4. Brenda 30 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Keshillit, çdo keshilltare deklaron me shkrim se në cilin grup politik bën pjesë.
5. Vetëm keshilltaret që nuk bëjnë deklarin e mësipërm ose që nuk i përkasin asnjë grupi politik mund të formojnë grup të përzier.
6. Çdo keshilltare ka të drejtë të largohet nga grupi politik. Për këtë ai duhet t'i paraqesë një deklaratë me shkrim kryesisë së grupit dhe të njoftojë me shkrim Kryesinë e Keshillit.

Neni 17 Kryesia e grupit politik

1. Çdo grup politik, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryesinë e tij. Për zgjedhjen e kryesisë, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të përbërjes së grupeve politike ose kryesive të tyre, vihet në dijeni Kryetari i Keshillit.
2. Kryetari i Keshillit zhvillon takim me kryetarët e grupeve politike me qëllim përcaktimin e vendeve të grupeve politike në sallën e Keshillit. Vendet e keshilltareve të secilit grup politik përcaktohen nga kryetari i secilit grup.

KREU IV ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË KESHILLIT DHE TË KOMISIONEVE TË TIJ

Neni 18 Programi i punës së Keshillit

1. Keshilli i zhvillon punimet në seancë mbledhje dhe në komisione, sipas një programi të caktuar.



2. Programi i punës së Keshillit përcaktohet nga Kryesia e Keshillit me mirëkuptim dhe i njoftohet Keshillit. Për programin e punës çdo Keshilltare, mund të diskutoje në mbledhje dhe mund të beje propozime konkrete, për jo më shumë se 2 minuta, për të cilat Keshilli vendos me votim të hapur. Programi i punës përmban listën e çështjeve që do të shqyrtojë Keshilli.
3. Në rast se në Kryesine e Keshillit nuk arrihet mirëkuptimi për programin e punës së Keshillit, ai hartohet nga Kryetari për një periudhë 3-mujore dhe i paraqitet për miratim Keshillit në mbledhje. Në programin e paraqitur Kryetari merr në konsideratë propozimet e bëra nga kryetarët e grupeve të Keshilltareve. Për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime në program, të propozuara me shkrim nga një grup prej 3 (tre) Keshilltaresh votohet pa debat në mbledhje, pasi është dëgjuar për jo më shumë se 2 minuta një folës pro dhe një folës kundër.
4. Në programin e punës së Keshillit futen automatikisht shkresat e Prefektit të Qarkut për rishqyrtim vendimesh, projekt vendime financiare ose ndryshimi i Buxhetit të Keshillit Qarkut, propozimet për emërim dhe shkarkim perfaqesuesish të organeve që zgjidhen nga Keshilli, mocionet e kërkuara, projektvendimet e mbartuara nga programi paraardhës, si dhe çështjet që lidhen me gjendje të jashtëzakonshme.

Neni 19

Njoftimi i rendit të ditës dhe i mbledhjes pasardhëse

1. Në fillim të çdo mbledhje drejtuesi i saj bën të njohur rendin e ditës, në përputhje me kalendarin e punimeve.
2. Drejtuesi i mbledhjes para se të mbyllë mbledhjen, njofton rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme që miratohet nga keshilli.

Neni 20

Ndryshimi i rendit të ditës

1. Keshilli ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Për të diskutuar ose vendosur në mbledhje për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Keshilli merr vendim me jo më pak se 50+1 % të perberjes së keshillit. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 3 (tre) keshilltare, nga një kryetar grupi keshilltaresh ose nga Kryetari Keshillit Qarkut vetëm para fillimit të mbledhjes, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi.
3. Keshilli mund të vendosë në çdo kohë që komisionet e përhershme të kenë në rendin e tyre të ditës një ose më shumë çështje, në përputhje me programin e punës dhe me kalendarin e punimeve të Keshillit.



KREU V
ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME

Neni 21
Mbledhjet e komisioneve

1. Mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga kryetari i tij. Ato mund të thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së anëtarëve të komisionit ose me kërkesën e Kryetarit të Keshillit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.
2. Komisionet e përhershme nuk mund të mblidhen gjatë kohës kur Keshilli është i mbledhur, përveçse me miratimin e Kryetarit të Keshillit.

Neni 22
Organizimi i punës

1. Kryetari i komisionit, në këshillim me zëvendëskryetarin, i propozon për miratim komisionit programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij. Kryetari i komisionit përgatit rendin e ditës, organizon punën për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit dhe kryeson mbledhjet e tij; përfaqëson komisionin në marrëdhënie me organet e tjera të Keshillit dhe administratën; nënshkruan dhe paraqet në mbledhje, raportin e shqyrtimit të çështjes në komision; vë në dukje pjesëmarrjen në komision; hedh në votë dhe shpall rezultatin e votimit.
2. Me kërkesën e shumicës së anëtarëve të komisionit, kryetari thërret për raportim ose informim para komisionit drejtuesit e drejtorive, sektoreve apo zyrave të administratës së Keshillit Qarkut si dhe institucioneve publike në vartësi të Keshillit Qarkut.
3. Kryetari i komisionit informon komisionin për çdo veprimtari që kryen në emër të tij.

Neni 23
Vendimmarrja në komision

1. Vendimet merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të komisionit.
2. Mendimi i anëtarëve që kanë mbetur në pakicë, në çdo rast shënohet në procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së komisionit dhe i bashkëngjitet mendimit të shumicës së komisionit.



Neni 24 Seancat dëgjimore publike

1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me përfaqësues të institucioneve shtetërore e publike ne vartesi te Keshillit Qarkut, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.
2. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.
3. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin e komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.

Neni 25 Mbledhjet e përbashkëta të komisioneve

1. Komisionet, kur përcaktohet në programin e punës së Keshillit ose kur e shohin të nevojshme, mund të bëjnë mbledhje të përbashkëta. Mbledhjen e përbashkët e kryeson njëri nga kryetarët e komisionit që zgjidhet me marrëveshje ndërmjet tyre dhe, kur kjo nuk arrihet, mbledhjen e kryeson kryetari i atij komisioni që ka më tepër lidhje me çështjen në shqyrtim, i caktuar nga Kryetari i Keshillit.
2. Në mbledhjet e përbashkëta të komisioneve zbatohen rregullat e parashikuara në nenet e kësaj Rregulloreje për komisionet dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
3. Mbledhjet e përbashkëta të komisioneve dalin me një raport të vetëm. Kur qëndrimet e komisioneve janë të ndryshme, ato paraqiten veçmas në raportin përfundimtar të mbledhjes.

Neni 26 Veprimtaria e keshilltareve

1. Keshilltaret janë në veprimtari si te tille kur ata marrin pjesë në mbledhjen e keshillit dhe në mbledhjet e komisioneve; kur marrin pjesë në veprimtari te organizuar te Keshillit Qarkut brenda ose jashtë vendit.
2. Anëtarët e Keshillit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes.



Neni 27

Aktivizimi i specialistëve të jashtëm

1. Komisionet ose këshilli, në përputhje me vendimin e Keshillit të Qarkut, për realizimin e detyrave të tyre mund të aktivizojnë specialistë të fushave të ndryshme.

KREU VI

ZHVILLIMI I MBELEDHJEVE

Neni 28

Publiciteti i Mbledhjeve të Keshillit

1. Mbledhjet e Keshillit bëhen të hapura, me përjashtim të rastit kur Keshilli vendos ndryshe.
2. Kërkesën për të zhvilluar mbledhje të mbyllur mund ta bëjë Kryetari i Keshillit ose të paktën një e katërta e të gjithë Keshilltareve, duke e motivuar atë. Pas dëgjimit të kërkesës dhe diskutimeve rreth saj, vendoset me votim të hapur me shumicën e të gjithë anëtarëve të Keshillit. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes së mbyllur, drejtuesi i mbledhjes u kërkon personave të ftuar, medias dhe personave nga publiku të largohen nga salla.
3. Nuk mund të zhvillohen mbledhje të mbyllura gjatë shqyrtimit të Buxhetit ose projekt-endimeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Neni 29

Fillimi i mbledhjes

1. Kryetari i Keshillit ose Zëvendëskryetari i autorizuar prej tij, hap dhe mbyll mbledhjen e keshillit.
2. Mbledhja fillon me miratimin e rendit të ditës. Kur nuk ka vërejtje ai quhet i miratuar dhe, nëse kërkohet, ai votohet me ngritjen e dorës. Për vërejtje të rendit të ditës fjala u jepet vetëm keshilltareve që kërkojnë të propozojnë ndryshime të argumentuar për jo më shumë se 1 minuta kohe.
3. Në fillim të mbledhjes drejtuesi i saj njofton projekt-vendimet e depozituara në Keshill, mesazhet, peticionet, kërkesat dhe ankesat drejtuar Keshillit. Nuk njoftohen peticionet anonime dhe ato që kanë përmbajtje të kundërligjshme.

Neni 30

Çështje që s'janë në rendin e ditës

1. Para fillimit të rendit të ditës çdo keshilltare mund të diskutojë për çështje të ndryshme që ai i konsideron se duhen bërë publike në mbledhje. Në këtë rast keshilltari nuk mund të flasë më shumë se 2 minuta dhe nëse diskuton në emër të



grupit keshillatreve, jo më shumë se 3 minuta. Drejtuesi i mbledhjes kujdeset të harmonizojë diskutimet e çdo keshillatri, sipas përkatësisë në grupin politik. Koha e përgjithshme për diskutimin e këtyre çështjeve nuk mund të jetë më shumë se 30 minuta. Në rast se me diskutime kalohet ky afat, Kryetari i Keshillit ndërpret diskutimet e keshillatreve dhe atyre që kanë ngelur pa diskutuar u jepet fjala në fillimin e mbledhjes pasardhese.

Neni 31 Diskutimet në mbledhje

1. Çdo keshilltare që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës duhet të regjistrohet para fillimit të mbledhjes tek Sekretari Keshillit. Lista e diskutuesve të regjistruar i bëhet e njohur Keshilltareve në fillim të mbledhjes.
2. Cdo Keshilltare kur diskuton ngrihet ne kembe dhe vazhdon diskutimin. Nuk lejohet diskutimi i ulur ne tavolinen e mbledhjes. Diskutimet fillojnë pasi drejtuesi i mbledhjes njofton hapjen e tyre. Asnjë keshilltare nuk mund të diskutojë pa i'u dhënë fjala nga drejtuesi i mbledhjes.
3. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
4. Lejohet ndërrimi i radhës së diskutimeve ndërmjet keshilltareve në marrëveshje mes tyre.
5. Keshilltari i cili, kur i jepet fjala nga drejtuesi i mbledhjes, nuk është në sallë, konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.
6. Drejtuesi i mbledhjes u jep fjalën diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup keshilltaresh. Kur lista e diskutuesve ka përfunduar ose nuk e kërkon më fjalën ndonjë Keshilltare tjetër, Kryetari u jep fjalën kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve të keshillatreve, duke filluar nga grupi më i vogël në numër.

Neni 32 Koha e diskutimeve

1. Çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 3 minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër.
2. Koha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dyfishohet kur çmohet e nevojshme për çështje konkrete, koha e diskutimeve mund të përcaktohet paraprakisht në Kryesinë e Keshillit në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, sipas përfaqësimit të tyre në Keshill, por në çdo rast jo më pak se 8 minuta për një grup keshilltaresh.



Neni 33
Çështje të procedurës

1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e mbledhjes ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.
2. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore.
3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 2 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër jo më shumë se 1 minute secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Keshilli me ngritjen e dorës.

Neni 34
Replika

1. Keshilltari ka të drejtën e replikës, kur ndaj tij janë shprehur fjalë të padenja apo të pahijshme, ose janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar thelbin e fjalës së tij. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 1 minute. Për të njëjtin diskutim keshilltari nuk mund të bëjë më shumë se një replikë. Keshilltaret nuk lejohen të bëjnë replikë ndaj replikës.

Neni 35
Sqarimi i votës kundër

1. Keshillatri ka të drejtën e sqarimit të arsyeve të votimit kundër deri në 1 minute. Kur kërkohet të bëhet sqarim për votimin kundër, atij i jepet fjala menjëherë pas votimit.

Neni 36
Ndërprerja e mbledhjes

1. Drejtuesi i mbledhjes, kur çmohet prej tij ose me kërkesën e një grupi politik apo të një komisioni të përhershëm, mund ta ndërpresë mbledhjen për jo më shumë se 30 minuta dhe vetëm një herë për të njëjtën çështje.



Neni 37

Mbajtja e qetësisë nga publiku

1. Personat e ftuar dhe publiku që ndjekin punimet e Keshillit në mbledhje, nuk duhet të shprehin shenja miratimi ose mosmiratimi dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e përcaktuara nga Kryesia e Keshillit për mbajtjen e qetësisë. Në rast shkeljeje të tyre, drejtuesi i mbledhjes urdhëron largimin e tyre nga salla.

Neni 38

Regjistrimi dhe publikimi i diskutimeve

1. Në mbledhjet e Keshillit mbahen proceverbale të përmbledhura, si dhe bëhet regjistrimi i plotë i tyre kur ka teknike regjistrimi. Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të mbledhjes dhe rendi i ditës së saj, pjesëmarrja e keshilltareve, përmbledhja e diskutimeve dhe e qëndrimeve të mbajtura nga keshillatret, si dhe rezultatet e votimit.
2. Çdo kush ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e procesverbaleve të Keshillit. Proces verbali i mbledhjeve nënshkruhet nga mbajtësi i proces verbalit dhe nga te paktën një përfaqësues për çdo grup keshilltaresh si dhe Kryetari i keshillit, brenda dy ditëve nga zhvillimi i mbledhjes dhe depozitohet tek sekretari i Keshillit të Qarkut për zbardhje vendimesh.

KREU VII

VERIFIKIMI I NUMRIT TË KESHILLTAREVE DHE VOTIMI

Neni 39

Kuorumi dhe vendimmarrja në mbledhje

1. Vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga Keshilli kur për to kanë votuar shumica e keshilltareve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Keshillit, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre.
2. Drejtuesi i mbledhjes në leximin e rendit të ditës, i njofton Keshillit edhe shumicën që kërkon miratimi i projektvendimit.

Neni 40

Verifikimi i kuorumit

1. Përpara çdo votimi, drejtuesi i mbledhjes verifikon numrin e keshilltareve të pranishëm në sallë.
2. Drejtuesi i mbledhjes, në çdo kohë, si dhe kur kjo kërkohet nga të paktën 3 (tre) keshillatret, verifikon nëse në sallë është i pranishëm numri i kërkuar i keshilltareve.



Kërkesa për verifikimin e numrit të keshillatreve të pranishëm shprehet me ngritjen në këmbë të kërkuesve.

3. Për verifikimin e numrit të keshillatreve, drejtuesi i mbledhjes bën thirrjen në mënyrë nominale ose elektronike kur kjo është e mundur te realizohet.
4. Kur mungon numri i kërkuar i keshillatreve për marrjen e vendimit, drejtuesi i mbledhjes shtyn mbledhjen për 15 minuta dhe në rast se edhe pas kësaj kohe nuk arrihet numri i kërkuar e anulon atë. Në rast anulimi, drejtuesi i mbledhjes përcakton ditën e nesërme, me kusht që ajo të mos jetë ditë pushimi, si ditë në të cilën Keshilli do të mbledhet me të njëjtin rend dite, duke deklaruar njëkohësisht edhe orën e votimit për atë rend dite.

Neni 41

Votimi

1. Votimi është vetjak.
2. E drejta e votës nuk delegohet.
3. Votimi bëhet i hapur ose i fshehtë.
4. Me fillimin e votimit nuk lejohet të bëhen më diskutime dhe as i jepet fjala ndokujt deri në shpalljen e rezultatit të votimit. Votimi nuk ndërpritet për asnjë arsye.

Neni 42

Votimi i hapur

1. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
2. Votimi bëhet përherë i hapur në rastet e miratimit të rendit të ditës dhe rishqyrtimit të vendimeve të kthyera nga Prefekti Qarkut si dhe votimit të Buxhetit të Keshillit Qarkut ose të projekt-vendimeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Neni 43

Votimi nominal

1. Votimi nominal mund të kërkohet nga të paktën 3 (tre) keshilltarë dhe vendoset me votim nga Keshilli. Kërkesa për votim nominal duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i mbledhjes mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar keshilltarët të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
2. Në votimin nominal drejtuesi i mbledhjes ose sekretari i keshillit thërret keshilltarët sipas rendit alfabetik dhe ata përgjigjen me zë të lartë pro, kundër ose abstenim.
3. Në rastin e mocionit të besimit ose të mocionit të mosbesimit votimi në Keshill bëhet kurdoherë nominal.
4. Në rastin e votimit nominal, lista e keshilltareve votues me shënimin e votës pro, kundër ose abstenim të secilit keshilltarë, fiksohet në procesverbal së bashku me materialet e mbledhjes.



Neni 44 Votimi i fshehtë

1. Votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat.
2. Votimi i fshehtë, përveç rasteve kur nuk lejohet të kryhet sipas Kushtetutës, ligjit ose kësaj Rregulloreje, mund të kërkohej nga të paktën 3 (tre) keshilltare dhe vendoset me votim nga Keshilli. Kërkesa për votim të fshehtë duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i seancës mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar keshilltaret të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
3. Votimi i fshehtë bëhet duke hedhur në kutinë e votimit fletën e votimit ose në mënyrë elektronike.
4. Fleta e votimit të fshehtë duhet të përmbajë të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim. Në fletën e votimit keshilltari shënon me një shenjë të dallueshme dhe të qartë për zgjedhjen e bërë në alternativën për të cilën është dakord.
5. Në rast se fleta e votimit përmban më shumë se një kandidat, përbri emrave të tyre vendoset një kuadrat, në të cilën keshilltari duhet të vendosë shenjën për zgjedhjen e bërë.

Neni 45 Shpallja e rezultatit të votimit

1. Çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Keshillit është i pavlefshëm.
2. Rezultati i votimit në mbledhje shpallet nga drejtuesi i mbledhjes, duke përdorur togfjalëshin "Miratohet nga keshilli" ose "Nuk miratohet nga Keshilli".

PJESA E DYTË PROCEDURA VENDIMARRESE

KREU I NISMA VENDIMARRESE

Neni 46 Propozimi i vendimeve

1. E drejta për të propozuar vendime i takon Kryetarit të Keshillit, çdo grupi politik dhe çdo keshilltari.
2. Projekt-vendimet duhet të jenë të hartuara në formën e një akti normativ dhe të jenë të shoqëruara me një relacion, i cili duhet të përmbajë objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij, argumentet se këta objektiva nuk mund të arrihen me vendimet ekzistuese, përputhshmërinë e projektvendimit me ligjin për



funksionimin e qeverisjes vendore, harmonizimin me vendimet e tjera dhe legjislacionin në fuqi, si dhe efektet e tij sociale dhe ekonomike. Për projektvendimet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij.

3. Asnjë projektvendim, që rrit shpenzimet e Buxhetit të Bashkise ose pakëson të ardhurat e tij, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Kryetarit të Keshillit Qarkut, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve nga data e marrjes së projektvendimit.
4. Kryetari i Keshillit, në mënyrë të arsyetuar, mund të kthejë te nismëtari projektvendimin e depozituara, në rast se nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 47

Shpërndarja e projekt-vendimeve

1. Projekt-vendimet, pasi regjistrohen sipas rendit të paraqitjes së tyre në një regjistër të veçantë, i kalohen Kryetarit të Keshillit.
2. Kryetari i Keshillit urdhëron menjëherë shpërndarjen e tyre Keshilltareve ne perputhje me rendin e dites te miratuar me pare. Kopje të projekt-vendimeve u vihen në dispozicion, me kërkesën e tyre, medias ose personave të tjerë.
3. Projekt-vendimet nuk mund të futen në kalendarin e punimeve të Keshillit pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së tyre, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore përcaktohet ndryshe.

Neni 48

Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera

1. Në përputhje me programin e punës së Keshillit, Kryetari i Keshillit i dërgon për shqyrtim projektvendimet në komisionin përgjegjës dhe në komisionet që sipas kësaj Rregulloreje duhet të paraqesin mendimin e tyre.
2. Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera shumëfishohen dhe u shpëndahe Keshillatreve ne mbledhjen e Keshillit.

Neni 49

Tërheqja e nismës

1. Nismëtari i projekt-vendimit mund ta tërheqë projektin e tij deri në çastin kur ai nuk është votuar në parim në mbledhjen e Keshillit.

Neni 50

Shqyrtimi në mbledhjen e Keshillit

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit në mbledhjen e keshillit përfshin diskutimin në parim për dhe shqyrtimin nen për nen të tij.
2. Para fillimit të diskutimit në parim keshilltaret ftohen nga drejtuesi i mbledhjes t'i drejtojnë pyetje nismëtarëve që kanë lidhje me projekt-vendimin.



3. Diskutimi në parim për projekt-vendimin zhvillohet si në rastin kur komisioni përgjegjës është shprehur për miratimin e tij në parim, ashtu edhe në rastin kur janë shprehur për mosmiratimin e tij. Në rastin kur komisioni përgjegjës është shprehur për mosmiratimin në parim dhe Keshilli në mbledhje vendos miratimin e tij, projekt-vendimi kthehet në komisionin përgjegjës për vazhdimin e shqyrtimit të tij nën për nën.

KREU II PROCEDURA TË VEÇANTA

Neni 51

Për rishqyrtimin e vendimeve të kthyera nga Prefekti Qarkut

1. Kur Prefekti Qarkut në përputhje me ligjin, rikthen vendimin për rishqyrtim në Keshill, Kryetari i Keshillit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
2. Komisioni përgjegjës e shqyrton vendimin vetëm për çështjet e paraqitura nga Prefekti i Qarkut dhe brenda mbledhjes para paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të vendimit.

PJESA E TRETE TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KESHILLIT

Neni 52

Veprimtaria e hapur e Keshillit

1. Veprimtaria e Keshillit është e hapur, me përjashtim të rastit të parashikuar ndryshe nga kjo Rregulloreje.
2. Veprimtaria e hapur e Keshillit realizohet nëpërmjet:
 - a) pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimarrës;
 - b) pasqyrimin të veprimtarisë së Keshillit dhe organeve të tij në medianë e shkruar dhe vizive;
 - c) botimeve të dokumentacionit;
 - ç) faqes së internetit të Keshillit;
 - d) rrjetit të brendshëm audiovizual.

Neni 53

Dokumentacioni i keshillit

1. Dokumentacioni i keshillit përfshin:
 - a) vendimet, rezolutat, deklaratat dhe projektet e keshillit;
 - b) dokumentet që lidhen me ushtrimin e funksioneve të Kryetarit të Keshillit;
 - c) dokumentet që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të Keshillit;
 - d) dokumentet që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve të Keshillit;
 - e) dokumentet që lidhen me veprimtarinë e organeve të Keshillit;



Neni 54

Zgjedhja në organet perfaqesuese ose të krijuara me ligj

1. Kandidaturat për në organet qe me ligj, zgjidhen nga Keshilli, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 3 keshilltare dhe të përmbajnë një curriculum vitae të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin.
2. Kandidaturat duhet të propozohen 30 deri në 15 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të anëtarit të organit perfaqesues.
3. Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Keshillit ia kalon ato menjëherë komisionit përkatës, i cili vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kushtet ligjore brenda dy javëve nga marrja e kërkesës.
4. Keshilli kryen votimin për kandidatët jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i mandatit ose nga data e shkarkimit.
5. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 55

Shkarkimi i anëtarëve të organeve qe jane ne kompetence te keshillit

1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve qe jane ne kompetence te keshillit paraqiten, nga kerkuesit si Kryetari Keshillit, nje grup keshilltaresh dhe jo me pak se 3 Keshilltare, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj.
2. Kryetari i Keshilli ia përcjell kërkesën, së bashku me dokumentacionin shoqërues, komisionit të përhershëm përkatës, i cili duhet të paraqesë një raport për mbledhjen e radhes te Keshillit.
3. Kryesia e Keshillit përcakton datën e votimit në Keshill të kërkesës për shkarkim dhe, në rast se kërkohet nga një kryetar grupi politik, edhe kohën e debatit.

PJESA E KATERT

INTERPRETIMI E NDRYSHIMI I RREGULLORES

Neni 56

Interpretimi i rregullores

1. Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të mbledhjes lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, është kompetencë e drejtuesit të mbledhjes për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.
2. Kur ngrihen pretendime për interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje gjatë



zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve, kryetari i komisionit vendos për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.

3. Kryetari i Keshillit, një kryetar grupi keshilltaresh, një komision i përhershëm ose 3 keshilltaresh mund të kërkojnë që çështja e interpretimit për një rast të veçantë t'i paraqitet Keshillit në mbledhje për të marrë vendim.

Neni 57
Ndryshimi i Rregullores

1. Çdo keshilltare ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Keshillit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektvendimeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Keshillit.

Neni 57
Hyrja ne fuqi Rregullores

1. Kjo rregullore hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes se vendimit per kete qellim
2. Rregullorja u miratua me date 16.10.2015

KRYETARI
Gjok Ndoka